



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 400/01-19475, dt. 17 Prill 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Leutrim (Florim) Kelmendi dhe Ramë (Bajram) Muzlijaj, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 17 Prill 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 09/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Leutrim (Florim) Kelmendi dhe Ramë (Bajram) Muzlijaj me qëllim të Krijimit të Hapësirës për Varreza në fshatin Ramun, si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të krijimit të hapësirës për varreza në fshatin Ramun, si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr. 203-3 në sipërfaqe prej 5039m² ZK Ramun pronë e pronarëve Leutrim (Florim) Kelmendi me ¼ dhe Ramë (Bajram) Muzlija me ¾ do të merret me qëllim të krijimit të hapësirës për varreza në fshatin Ramun si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me ngastrat kadastrale nr. 33-4 me sipërfaqe prej 25m² ZK Llabjan, nr. 246-4 me sipërfaqe prej 67m² ZK Zahaq, nr. 118-9 me sipërfaqe prej 148m² ZK Zahaq dhe nr. 3-31 me sipërfaqe prej 12790m² ZK Leshan pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 05.02.2025.

-Prona e Komunës janë vlerësuar si më poshtë:

- ngastra kadastrale nr. 118-9 në sipërfaqe prej 148m² ZK Zahaq është vlerësuar me 120€/m², që në total i bie 17,760.00 €.
- ngastra kadastrale me nr. 246-4 në sipërfaqe prej 67m² ZK Zahaq është vlerësuar me 120€/m², që në total i bie 8,040.00 €.
- ngastra kadastrale me nr. 3-31 në sipërfaqe prej 12790 m² ZK Leshan është vlerësuar me 8.00 €/m² që në total i bie 102,320.00 €.
- ngastra kadastrale me nr. 33-4 në sipërfaqe prej 25 m² është vlerësuar me 120 €/m², që në total i bie 3,000€.

-Prona private e bashkëpronarëve privat Leutrim (Florim) Kelmendi me $\frac{1}{4}$ dhe Ramë (Bajram) Muzliqaj me $\frac{3}{4}$, ngastra kadastrale nr.203-3 në sipërfaqe prej 5039m² ZK Ramun është vlerësuar 10.00 €/m² që në total i bie 50,390.00 €.

- Andaj obligohen bashkëpronarët privat Leutrim (Florim) Kelmendi dhe Ramë (Bajram) Muzliqaj që të paguajnë diferencën në shumën prej 80,730.00 € Komunës së Pejës bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore–Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

